



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2581/6 prot.

Datë 09.12.2022

V E N D I M

Nr. 1221/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.12.2022 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Medi-Tel” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-44722-10-06-2022, me objekt “Trajtim dhe Evadim te Mbetjeve te Rrezikshme Spitalore DSHS-KURBIN per vitin 2022- Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik – ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara- me afat 1 vjeçar (12 muaj)” me fond limit 1,000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 17.10.2022, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kurbin
- Ankimues:** “Medi-Tel” SHPK
*Autostrada Tiranë-Durrës, Km.1, Rruga Vidhegjate,
Ndertesa Nr.18, Zona Kadastrale Nr.2679, Nr.pronesie
41/1/16/2*
- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Shërbimit Spitalor Kurbin
Lagjia Nr 4 Laç – Kurbin
- Subjekt i interesuar:** “V.A.L.E RECYCLING” SHPK
*Lezhë Fushe Kuqe GUREZ Fshatin Gurez, afer ish
Kanalit te Acidit*
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Operatori ekonomik ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 07.10.2022 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-44722-10-06-2022, me objekt “Trajtim dhe Evadim te Mbetjeve te Rrezikshme Spitalore DSHS-KURBIN per vitin 2022- Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik – ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara- me afat 1 vjeçar (12 muaj)” me fond limit 1,000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 17.10.2022, nga autoriteti kontraktor, Drejtorja e Shërbimit Spitalor Kurbin.

II.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 28.10.2022 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- “Medi-Tel” SHPK	890.000	lekë	skualifikuar
-“V.A.L.E RECYCLING” SHPK	958.500	lekë	kualifikuar

Operatori ekonomik ankimues “Medi-Tel” SHPK rezulton i skualifikuar me arsyetimin:

“Oferta juaj refuzohet pasi ka mangesi si me poshte :

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një kontratë të lidhur me një landfill te licensuar per depozitim e produktit final qe del nga trajtimi (Mbetje sipas VKM Nr.402, date 03.06.2021 “Per miratimin e katalogut te mbetjeve”), e cila duhet te jete aktive dhe e vlefshme ne momentin e hapjes se ofertave. Ne plotesim te ketij kriteri, subjekti Medi tel shpk ka paraqitur kontraten nr. 314 prot date 26.09.2022 te lidhur me shoqerine ”ECO-ELB” sh.a me objekt ”Per depozitim mbetjesh prane impjantit te perpunimit te mbetjeve urbane qarku Elbasan”

Referuar lejes mjedisore te ketij landfilli nr PN-5783-09-2017 ne seksionin ”Emërtimin përshkrues i veprimtarisë” percaktohet

”Leje mjedisi e tipit A për: Impjanti i trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit dhe prodhimit të energjisë”, ndersa ne akt miratimin e kesaj licence me nr.5634 prot., date 28.06.2022 me numer identifikimi 2694/1 percaktohet :

2.1 Titulli i instalimit: Impiant i Trajtimit te Mbetjeve Urbane te Qarkut te Elbasanit dhe Prodhimit te Energjise

2.2 Pershkrimi i veprimtarise dhe kapacitetit prodhues: Impiant i Trajtimit te Mbetjeve Urbane te Qarkut te Elbasanit dhe Prodhimit te Energjise. Siperfaqja e truallit e zene nga.... Ne kushtin 1 percaktohet :

Kjo Leje dhe kushtet e percaktuara ne te jepen per veprimtarite dhe kapacitetet ose ndryshimet e tyre te percaktuara ne kapitujt 2-4 te kerkeses per kete leje. Operatori eshte i autorizuar te zhvilloje veprimtarite dhe/ose veprimtarite e lidhura me to sic specifikohen ne Tabelen 1.1.1 dhe 1.1.2.

Sic shikohet ne kollonen ”Pershkrim i veprimtarise se specifikuar” percaktohet ”Impiant i Trajtimit te Mbetjeve Urbane te Qarkut te Elbasanit dhe Prodhimit te Energjise.

Referuar lejes mjedisore te ketij landfilli nr PN-1423-12-2015 ne seksionin ”Emërtimin përshkrues i veprimtarisë” percaktohet ”Leje mjedisi e tipit A për: Lendfilli i mbetjeve (D1) duke përjashtuar lendfillin e mbetjeve inerte” ndersa ne akt miratimin e kesaj licence me nr.6584 prot., date 06.09.2022 me numer identifikimi 1983/1 percaktohet :

2.1 Titulli i instalimit: Lendfilli i mbetjeve (D1) duke perjashtuar lendfillin e mbetjeve inerte.

2.2 Pershkrimi i veprimtarise dhe kapacitetit prodhues: Lendfilli i mbetjeve (D1) duke perjashtuar lendfillin e mbetjeve inerte. Siperfaqja ku zhvillohet veprimtaria eshte 19542m2 • Kapaciteti i projektuar eshte 10000 ton/dite ose me I madh se 25000 ton.

SHTOJCA 4.2 -MENAXHIMI I MBETJEVE-Ruajtja

TABELA 4.2.1 : Mbetjet e ruajtura ne vendndodhjen e Pershkrirne i mbetjes Vendndodhja e vendit te ruajtjes Menyra e ruajtjes Kushtet e ruajtjes Mbetje te parrezikshme urbane dhe

mbetjet e gjeneruara nga Incineratori I rnbetjeve urbane Lendfilli i rnbetjeve Elbasan Lagjja "Skenderbej" Depozitim nen dhe ose rmbi dhe (lendfill Te respektohen kushtet teknike te operimit te punes ne lendfill. Pas 9do cikli pune te behet rnbulimi rnbulimi i mbetjeve ne asnje rast nuk duhet te kemi depozitim te mbetjeve te rrezikshme.

Aktin e Themelimit te shoqerise "ECO-ALB",

"NENI 2

Qellimi i krijimit te shoqerise

I. Qellimi i krijimit te kesaj shoqerie eshte qe nepermjet aktivitetit lregtar, sipas objektit te percaktuar me poshte, le permbushe funksionin vendor dhe sherbimin publik per mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve le ngurta dhe shtepiake, si dhe te prodhoje e te shese energji elektrike qe gjenerohel nga procesi i trajtimit te mbetjeve, sikurse parashikohet nga kuadri ligjor e nenligjor ne fuqi.

2. Veprimtaria e kesaj shoqerie do te jete me karakter ekonomik dhe qellim fitimprures.

NENI 4

Objekti i veprimtarise Objekti i veprimtarise

I. Veprimtaria e shoqerise do te jete:

a) Grumbullimi, rehabilitimi dhe perpunimi i mbetjeve te ndryshme, organike. te ngurta, te gjelberta, etj., ne territorin administrativ te te gjitha bashkive te Qarkut Elbasan;

b) Trajtimi i mbetjeve me djegie (incenerator);

c) Prodhimi Aktivitete dhe te tjera shitja e ne energjise fushen e elektrike •

d) Aktivitete te tjera ne fushen e perpunimit te mbetjeve, qe lejon ligji, per interesat e shoqerise dhe te komunitetit;

Shoqeria, brenda kufijve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi, do te kryeje cdo operacion tregtar dhe financiar qe lidhet drejtperdrejte ose terthorazi me objektin e saj.

3. Shoqeria do te kryeje aktivitetin e saj pas marrjes dhe ne perputhje me licencat apo lejet perkatese."

Bazuar ne Statutin te shoqerise "ECO-ALB", ne nenin 3

"NENI 3

Objekti i veprimtarise

I. Veprimtaria e shoqerise do te jete:

a) Grumbullimi, rehabilitimi dhe perpunimi i mbetjeve te ndryshme, organike. te ngurta, te gjelberta, etj., ne territorin administrativ te te gjitha bashkive te Qarkut Elbasan;

b) Trajtimi i mbetjeve me djegie (incenerator);

c) Prodhimi Aktivitete dhe te tjera shitja e ne energjise fushen e elektrike •

d) Aktivitete te tjera ne fushen e perpunimit te mbetjeve, qe lejon ligji, per interesat e shoqerise dhe te komunitetit; Shoqeria, brenda kufijve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi, do te kryeje cdo operacion tregtar dhe financiar qe lidhet drejtperdrejte ose terthorazi me objektin e saj.

3. Shoqeria do te kryeje aktivitetin e saj pas marrjes dhe ne perputhje me licencat apo lejet perkatese."

Referuar Lejeve mjedisore te sipercituara dhe aktit te themelimit te shoqerise rezulton qe Shoqeria "ECO-ELB" (landfill) nuk eshte i licensuar per te depozituar/trajtuar mbetjet e dala nga instalimet e incenerimit dhe te autoklavimet te subjekteve te treta por vetem te hireve qe dalin nga incenerimi i mbetjeve nga vete subjekti pas trajtimit te mbetjeve urbane. Gjithashtu rezulton qe ky subjekt eshte i licensuar vetem per trajtimin e mbetje urbane dhe te

ngurta te gjeneruara nga Bashkita e Qarkut te Elbasanit, sic perktahet ne statutin, aktin e themelimit dhe ne lejen mjedisore.

Landfill "ECO-ELB" ne lejet mjedisore, e ka te percaktuar qe do te administroje e klasifikojte mbetjet(hiret) qe vijne si rezultat i operacioneve te percaktuara ne lejet mjedisore te Tipit A qe vete zoteron, pra e thene ne menyre te thjeshte mund te trajtoje vetem hiret qe vijne nga incinerimi qe vete shoqeria "ECO-ELB" kryen. Kjo shihet qarte ne lejet mjedisore dhe licensat qe shoqeria "Albtek Energy" zoteron. Pervec sa me lart, kjo shoqeri, objektin e verpimtarise e ka vetem ne fushen e mbetjeve te ngurta Urbane, dhe jo per hiret e incenerimeve, ne Qarkun e Elbasanit.

3. Nuk plotëson Kriterin 2.3.5 për disponimin e automjetit: Nga ekstrakti historik rezulton se ky operator ekonomik në dhjetor 2021 ka përfunduar transferimin e asetëve/aktiveve dhe aktivitetit ekonomik tek subjekti Medi Tel 1 SHPK dhe këtë e ka deklaruar dhe regjistruar si në organet tatimore edhe në QKB. Në momentin e paraqitjes së ofertës në 14 prill 2022, ky OE nuk provon se e disponon automjetin e kërkuar, pasi të gjitha asetet si dhe veprimtarinë ekonomike, i ka transferuar që në dhjetor 2021 tek një subjekt tjetër.

4. Nuk plotëson kriterin 2.3.6 për disponimin e impianteve dhe makinerisë: Nga ekstrakti historik rezulton se ky OE në dhjetor 2021 ka përfunduar transferimin e asetëve/aktiveve dhe aktivitetit ekonomik tek subjekti MEDI TEL 1 ShPK dhe këtë e ka deklaruar si në organet tatimore dhe në QKB. Në momentin e paraqitjes së ofertës në 14 prill 2022, ky OE nuk provon se i disponon impiantet dhe makineritë e kërkuara, pasi të gjitha asetet dhe veprimtarinë ekonomike, i ka transferuar në dhjetor 2021 tek një subjekt tjetër.

5. OE MEDI TEL ShPK ka bërë deklarime të pasakta dhe të pavërteta në Shtojcën nr. 9, në lidhje me disponimin e automjetit dhe impianteve e makinerive, pasi nuk i disponon ato, por disponohen nga shoqëria MEDI TEL 1 ShPK (sipas ekstraktit historik në vendimin e asamblesë së përgjithshme me datë 09.12.2021 është miratuar procesi i transferimit të veprimtarisë ekonomike nga OE MEDI TEL te marrësi MEDI TEL 1) ”.

Persa me siper ne baze mos plotesimit te kritereve te mesiperme nga ana juaj si Operatori Ekonomik Medi-Tel shpk.”

II.3. Në datën 16.11.2022 nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik rezulton se është publikuar njoftimi i fituesit per procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.4. Në datën 18.11.2022 nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor është administruar ankesa me nr. ankimi elektronik A/2022/2703 dhe nr.2581 prot., datë 21.11.2022 e operatorit ekonomik “Medi-Tel” SHPK lidhur me skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr.2581/2 datë 21.11. 2022 u publikuan arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues.

II.6. Me shkresën nr. 454/4 prot., datë 30.11.2022, protokolluar me tonën me nr.2581/4 prot., datë 02.12.2022, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni lidhur me trajtimin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues “Medi-Tel” SHPK, në të cilin konstatohet se autoriteti kontraktor nuk e ka pranuar ankesën duke arsyetuar si më poshtë:

“[...]Nga analizimi i ankeses se paraqitur nga operatori ekonomik “Medi-Tel” SHPK verehet se:

Se pari, ne lidhje me arsyen e skualifikimit se OE nuk ka plotesuar Operatori ekonomik duhet të paraqesë një kontratë të lidhur me një landfill te licensuar per depozitim e produktit final qe del nga trajtimi (Mbetje sipas VKM Nr.402, date 03.06.2021 “Per miratimin e katalogut te mbetjeve”). e cila duhet te jete aktive dhe e vlefshme ne momentin e hapjes se ofertave sipas Kriteve ne DST,

KSHA konsaton se Operatori Ekonomik MEDI-TEL shp.k. ka dorezuar nje Kontrate Ne plotesim te ketij kriteri, ka paraqitur kontraten nr. 314 prot date 26.09.2022 te lidhur me shoqerine “ECO-ELB” sh.a me objekt ”Per depozitim mbetjesh prane impjantit te perpunimit te mbetjeve urbane qarku Elbasan”.

Nga argumenti i dhene sic pretendon OE MEDI-TEL sh.p.k se kjo Kontrate e lidhur me Shoqerine “ECO-ELB”sh.a eshte e vlefshme edhe per Drejtorine e Sherbimit Spitalor Kurbin nga ana e KSHA u verifikua Dokumentacioni i dorezuar dhe rezultoi:

Ne QKB te Shoqerise “ECO-ELB”sh.a Objekti i Aktivitetit thuhet:

Grumbullimi, rehabilitimi dhe perpunimi i mbetjeve te ndryshme, organike, te ngurta, te gjelberta,..etj, ne territorin administrativ te te gjithe bashkive te tarkut Elbasan. Trajtimi i mbetjeve me diegie (incenerator).

Pra sic verehet kjo Shoqeria ”ECO-ELB” sh.a e ka te percaktuar qarte Bashkite e Qarkut Elbasan per depozitim e Mbetjeve.

Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kurbin eshte ne Territorin Administrativ te Bashkise Kurbin. Sic verehet Bashkia Kurbin nuk eshte e perfshire ne QKR —ne e kesaj Shoqerie.

Gjithashtu nga KSHA bazuar ne Dokumentin e dorezuar , lejes mjedisore te ketij landfilli nr PN5783-09-2017 ne seksionin ”Emërtimin përshkrues i veprimtarisë” percaktohet ”Leje mjedisi e tipit A për: Impjanti i trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut të Elbasanit dhe prodhimit të energjisë”, ndersa ne akt miratimin e kesaj licence me nr.5634 prot., date 28.06.2022 me numer identifikimi 2694/1 percaktohet:

2.1 Titulli i instalimit: Impiant i Trajtitimit te Mbetjeve Urbane te Qarkut te Elbasanit dhe Prodhimit te Energjise.”

Përshkrimi i veprimtarise dhe kapacitetit prodhues:

Impiant i Trajtitimit te Mbetjeve Urbane te Qarkut te Elbasanit dhe Prodhimit te Energjise. Siperfaqja e truallit e zene nga....

Ne kushtin 1 percaktohet :

Kjo Leje dhe kushtet e percaktuara ne te jepen per veprimtarite dhe kapacitetet ose ndryshimet e tyre te percaktuara ne kapitujt 2-4 te kerkeses per kete leje. Operatori eshte i autorizuar te zhvilloje veprimtarite dhe Jose veprimtarite e lidhura me to sic specifikohen ne Tabelen 1.1.1 dhe 1.1.2.

Sic shikohet ne kollonen “Pershkrim i veprimtarise se specifikuar” percaktohet ”Impianti i Trajtitimit te Mbetjeve Urbane te Qarkut te Elbasanit dhe Prodhimit te Energjise.

Referuar lejes mjedisore te ketij landfilli nr PN-1423-12-2015 ne seksionin "Emërtimin përshkrues 'veprimtarisë" percaktohet "Leje mjedisi e tipit A për: Lendfilli i mbetjeve (DI) duke përjashtuar lendfillin e mbetjeve inerte" ndersa ne akt miratimin e kesaj licence me nr.6584 prot., date 06.09.2022 me numer identifikimi 1983/1 percaktohet.

2.1 Titulli i instalimit: Lendfilli i mbetjeve (DI) duke perjashtuar lendfillin e mbetjeve inerte.

2.2 Pershkrimi i veprimtarise dhe kapacitetit prodhues: Lendfilli i mbetjeve (DI) duke perjashtuar lendfillin e mbetjeve inerte. Siperfaqja ku zhvillohet veprimtaria eshte 19542m2 . Kapaciteti i projektuar eshte 10000 ton/dite ose me I madh se 25000 ton.

SHTOJCA 4.2 - :MENAXHIMI I MBETJEVE-Ruajtja

TABELA 4.2.1 : Mbetjet e ruajtura ne vendndodhje

Pershkrim i mbetjes Vendndodhja e vendit te ruajtjes Menyra e ruajtjes Kushtet e ruajtjes Mbetje te parrezikshme urbane dhe mbetjet e gjeneruara nga Incineratori I mbetjeve urbane Lendfilli i mbetjeve Elbasan Lagjja "Skenderbej" Depozitim nen dhe ose mbi dhe (lendfill Te respektohen kushtet teknike te operimit te punes ne lendfill. Pas çdo cikli pune te behet mbulimi mbulimi i mbetjeve ne asnje rast nuk duhet te kemi depozitim te mbetjeve te rrezikshme.

Akti e Themelimit te shoqerise "ECO-ALB",

"NENI 2

Qellimi i krijimit te shoqerise

I. Qellimi i krijimit te kesaj shoqerise eshte qe nepermjet aktivitetit lregtar, sipas objektit te percaktuar me poshte, le permbushe funksionin vendor dhe sherbimin publik per mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve le ngurta dhe shtepiake, si dhe te prodhoje e te shese energji elektrike qe gjenerohet nga procesi i trajtimit te mbetjeve, sikurse parashikohet nga kuadri ligjor e nenligjor ne fuqi.

2. Veprimtaria e kesaj shoqerise do te jete me karakter ekonomik dhe qellim fitimprures. NENI 4

Objekti i veprimtarise

Veprimtaria e shoqerise do te jete:

a) Grumbullimi, rehabilitimi dhe perpunimi i mberjeve te ndryshme, organike. te ngurta. te gjelberta, etj., ne territorin administrativ te te gjitha bashkive te Qarkut Elbasan,

b) Trajtimi i mbetjeve me djegie (incenerator):

c) Prodhimi Aktivitete dhe te tjera shitja e ne energjise fushen e elektrike

d) Aktivitete te tjera ne fushen e perpunimit te mbetjeve, qe lejon ligji, per interesat e shoqerise dhe te komunitetit, Shoqeria, brenda kufijve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi, do te kryeje cdo operacion tregtar dhe financiar qe lidhet drejtperdrejte ose terthorazi me objektin e saj.

3. Shoqeria do te kryeje aktivitetin e saj pas marrjes dhe ne perputhje me licencat apo lejet perkatese."

Bazuar ne Statutin te shoqerise "ECO-ALB", ne nenin 3

"NENI 3

Objekti i veprimtarise

I. Veprimtaria e shoqerise do te jete:

a) Grumbullimi, rehabilitimi dhe perpunimi i mbetjeve te ndryshme, organike. te ngurta. te gjelberta, etj., ne territorin administrativ te te gjitha bashkive te Qarkut Elbasan:

b) Trajtimi i mbetjeve me djegie (incenerator):

c) Prodhimi Aktivitete dhe te tjera shitja e ne energjise fushen e elektrike

d) Aktivitete te tjera ne fushen e perpunimit te mbetjeve, qe lejon ligji, per interesat e shoqerise dhe te komunitetit: Shoqeria, brenda kufijve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi, do te kryeje cdo operacion tregtar dhe financiar qe lidhet drejtperdrejte ose terthorazi me objektin e saj.

3. Shoqeria do te kryeje aktivitetin e saj pas marrjes dhe ne perputhje me licencat apo lejet perkatese.”

Referuar Lejeve mjedisore te sipercituara dhe aktit te themelimit te shoqerise rezulton qe Shoqeria "ECO-ELB" (landfill) nuk eshte i licensuar per te depozituar/rajtuar mbetjet e dala nga instalimet e incenerimit dhe te autoklavimet te subjekteve te treta por vetem te hireve qe dalin nga incenerimi i mbetjeve nga vete subjekti pas trajtimit te mbetjeve urbane.

Gjithashtu rezulton qe ky subjekt eshte i licensuar vetem per trajtimin e mbetje urbane dhe te ngurta te gjeneruara nga Bashkete e Qarkut te Elbasanit, sic perktahet ne statutin, aktin e themelimit dhe ne lejen mjedisore.

Landfill "ECO-ELB" ne lejet mjedisore, e ka te percaktuar qe do te administroje e klasifikojte mbetjet(hiret) qe vijne si rezultat i operacioneve te percaktuara ne lejet mjedisore te Tipit A qe vete zoteron, pra e thene ne menyre te thjeshte mund te trajtoje vetem hiret qe vijne nga incinerimi qe vete shoqeria "ECO-ELB" kryen. Kjo shihet qarte ne lejet mjedisore dhe licensat qe shoqeria "Albtek Energy".

Përveç sa me lart, kjo shoqeri, objektin e verpimtarise e ka vetem ne fushen e mbetjeve te ngurta urbane, dhe jo per hiret e incenerimeve, ne Qarkun e Elbasanit.

Komisioni mban ne konsiderate se ne nenin 92, te Ligjit nr 162 date 23.12.2020 "Per Prokurimin Publik "ne fuqi ,pika 3: Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesot dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji , dhe te Nenit 82 te VKM-se Nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimir e rregullave te prokurimit publik".

Sa me siper pretendimi i operatorit ekonomik ankimues MEDI-TEL sh.p.k nuk qendron.

Se dyti, Subjekti Ankues MEDI-TEL sh.p.k pretendon se i plotëson Kriterin 2.3.5 për disponimin e automjetit: Per kete ka dorezuar ne Ankim edhe Dokumentacionet shoqeruese te Bilancit.

Nga verifikimi i kryer nga KSHA rezultoi se ne ekstrakti historik te OE MEDI —TEL sh.p.k rezulton se ky operator ekonomik në dhjetor 2021 ka përfunduar transferimin e asetëve/aktiveve dhe aktivitetit ekonomik tek Subjekti Medi Tel 1 SHPK dhe këtë e ka deklaruar dhe regjistruar si në organet tatimore edhe në QKB.

Ne Kontraten e bere ndemjet paleve depozituar ne QKB,ku thuhet Objekti :

Objekti i kontrates eshte transferimi i plotë i veprimtarise ekonomike, tregtare nga transferuesi tek marresi i transferimit duke percaktuar dhe kushtet dhe kriteret teknike te kryerjes se ketij transferimi.

OE MEDI -TEL sh.p.k shpk nuk rezulton qe kete Pasqyre Fianciare ta kete dorezuar ne QKB qe te provohet se e disponon automjetin e kërkuar, pasi të gjitha asetet si dhe veprimtarinë ekonomike, i ka transferuar që në dhjetor 2021 tek një subjekt tjetër.

Pra Komisioni ne vleresimin e Ofertes eshte bazuar ne Dokumentacionin e dorezuar ne momentin e hapjes se ofertave. Pasqyra Financiare jane dorezuar nga MEDI-TEL sh.p.k vetem ne momentin e Ankimimit.

KSHA veren se bazuar ne piken 2, te nenit 82, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar, parshikohet se , Komisioni i vleresimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme”.

Si rezultoi se OE MEDI -TEL sh.p.k shpk kete Pasqyre Fianciare ta kete dorezuar ne QKB , qe te provohet se e disponon automjetin e kërkuar, pasi të gjitha asetet si dhe veprimtarinë ekonomike, i ka transferuar që në dhjetor 2021 tek një subjekt tjetër.

Pra per sa me siper pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qendron.

Se treti, ne lidhje me kriterin 2.3.6 ku parashikohet për disponimin e impianteve dhe makinerisë:

Subjekti Ankues Medi-Tel sh.p.k pretendon se i plotëson kete kriter.

Nga verifikimi i kryer nga KSHA rezultoi se ne ekstrakti historik te OE MEDI —TEL sh.p.k rezulton se ky operator ekonomik në dhjetor 2021 ka përfunduar transferimin e asetëve/aktiveve dhe aktivitetit ekonomik tek Subjekti Medi Tel 1 SHPK dhe këtë e ka deklaruar dhe regjistruar si në organet tatimore edhe në QKB.

Ne Kontraten e bere ndermjet paleve depozituar ne QKB , ku thuhet Objekti :

Objekti i kontrates eshte transferimi i plote i veprimtarise ekonomike tregtare nga transferuesi tek marresi i transferimit duke percaktuar dhe kushtet dhe kriteret teknike te kryerjes se ketij transferimi.

OE MEDI -TEL sh.p.k shpk nuk rezulton qe kete Pasqyre Fianciare ta kete dorezuar ne QKB. qe te provohet se e disponon automjetin e kërkuar, pasi të gjitha asetet si dhe veprimtarinë ekonomike, i ka transferuar që në dhjetor 2021 tek një subjekt tjetër.

Pra Komisioni ne vleresimin e Ofertes eshte bazuar ne Dokumentacionin e dorezuar ne momentin e hapjes se ofertave.

Pasqyra Financiare jane dorezuar nga MEDI-TEL sh.p.k vetem ne momentin e Ankimimit.

KSHA veren se bazuar ne piken 2, te nenit 82, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar, parshikohet se 5 Komisioni i vleresimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme”.

Rezulton se OE MEDI -TEL sh.p.k shpk kete Pasqyre Fianciare nuk e ka dorezuar ne QKB , qe te provohet se e disponon impiantet dhe makinerite, pasi të gjitha asetet si dhe veprimtarinë ekonomike, i ka transferuar që në dhjetor 2021 tek një subjekt tjetër.

Pra per sa me siper pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qendron.

Se katerti, Subjekti Ankues MEDI-TEL sh.p.k pretendon se i plotëson kriteret dhe deklarimi i bere sipas Shtojcën nr. 9.

Nga verifikimi i kryer nga KSHA rezultoi se sipas ekstraktit historik në Vendimin e Asamblesë së përgjithshme me datë 09.12.2021 është miratuar procesi i transferimit të veprimtarisë ekonomike nga OE MEDI TEL te marrësi MEDI TEL 1”.

Pra sipas Vendimit të Asamblesë OE MEDI TEL ShPK në lidhje me disponimin e automjetit dhe impianteve e makinerive, nuk i disponon ato, por disponohen nga shoqëria MEDI TEL 1 ShPK. Shtojca me nr. 9 rezulton të kete deklarime të pasakta. Gjithashtu ne QKB nuk rezulton të jene ngarkuar Pasqyrat Financiare ,as Faturat perkatese dhe as ne Oferten perkatese te dorezuar me date 17.10.2022.

KSHA vëren se bazuar ne piken 2, te nenit 82, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar, parshikohet se Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme”.

Pra per sa me siper pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qendron.[...]

II.7. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se nuk janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara në kuptim të nenit 113 të LPP-së në formë shkresore dhe as në sistemin elektronik të ankesave.

II.8. Me shkresën nr. 472/1 prot., datë 01.12.2022 protokolluar me tonën nr. 2581/5 prot., datë 05.12.2022 Autoriteti kontraktor ka dërguar në Komisionin e Prokurimit Publik një informacion shtesë duke vënë në dijeni se e ka patur të pa mundur të ngarkojë në sistemin elektronik vendimmarrjen mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomi ankimues por e ka dërguar atë përmes e-mail si dhe në formë shkresore përmes shërbimit postar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Medi-Tel” SHPK, për skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit për shkak se nuk plotëson kriterin:

“Operatori ekonomik duhet të paraqesë një kontratë të lidhur me një landfill të licensuar për depozitimin e produktit final që del nga trajtimi (Mbetje sipas VKM Nr.402, date 03.06.2021 “Per miratimin e katalogut të mbetjeve”). e cila duhet të jete aktive dhe e vlefshme ne momentin e hapjes se ofertave sipas Kriteve ne DST,.” KPP vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8 të modifikuar të dokumenteve standarde të tenderit, kriteret e veçanta të kualifikimit, “aftësitë teknike dhe profesionale” pika 2.3.3. autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqese:

-6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një kontratë të lidhur me një landfill të licensuar për depozitimin e produktit final që del nga trajtimi.

(Mbetje me kod 19 01 11 , 19 01 12 dhe mbetje me kod 19 03 05 sipas VKM Nr.402, date 03.06.2021 “Per miratimin e katalogut të mbetjeve”), e cila duhet të jete aktive dhe e vlefshme. në momentin e hapjes së ofertave.

III.1.2. Në përmbushje të kriterit më sipër operatori ekonomik ankimes ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë me nr. 314 prot., datë 26.09.2022 të lidhur mes palëve shoqëria “Eco-Elb” Sha dhe “Medi-Tel” SHPK me objekt “Per depozitim mbetjesh pranë impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane Qarku Elbasan”

III.1.3. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji..”

Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika 2, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.4. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka

në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili për zgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.5. Në rastin konkret nisur nga arsyeja e skualifikimi të operatorit ekonomik ankimes se se nuk ka plotësuar kriterin *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë një kontratë të lidhur me një landfill të licensuar për depozitimin e produktit final që del nga trajtimi (Mbetje sipas VKM Nr.402, date 03.06.2021 “Per miratimin e katalogut të mbetjeve”). e cila duhet të jete aktive dhe e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave sipas Kriterëve në DST”* me arsyetimin se shoqëria “Eco-Elb” Sha e ka objektin e veprimtarisë për Grumbullimi, rehabilitimi dhe perpunimi i mbetjeve të ndryshme, organike, të ngurta, të gjelberta,..etj, në territorin administrativ të të gjithë bashkive të Qarkut Elbasan si dhe landfilli “Eco-Elb” SHA në leje mjedisore e ka të përcaktuar që mund të trajtojë vetëm huret që vijnë nga incenerimi që vetë shoqëria “Eco-Elb” sha kryen, Komisioni e gjykon të padrejtë vendimin e KVO-së se autoritetit kontraktor, pasi referuar ekstraktit historik të shoqërisë “Eco-Elb” Sha në pikën 12. *“Objekti i aktivitetit” përcaktohet “Grumbullimi, rehabilitimi dhe perpunimi i mbetjeve të ndryshme, organike, të ngurta, të gjelberta,..etj, në territorin administrativ të të gjithë bashkive të Qarkut Elbasan. Trajtimi i mbetjeve me diegie (incenerator). Prodhimi dhe shitja e energjise elektrike. Aktivitete të tjera në fushën e perpunimit të mbetjeve, që lejon ligji, për interesat e shoqërisë dhe të komunitetit...;”* çka do të thotë që shoqëria “Eco-Elb”Sha kryen proceset grumbulluese, rehabilituese dhe perpunuese për mbetjet në territorin administrativ të Qarkut Elbasan” por kjo nuk mund të pengojë subjekt të tjera të cilat të lidhin një kontratë me shoqërinë “Eco-Elb” SHA me qëllim grumbullimin, rehabilitimin dhe perpunimin e mbetjeve nga kjo shoqëri edhe pse nuk i përkasin Qarkut të Elbasanit për sa kohë që në kontratën e lidhur mes palëve si në rastin konkret është e përcaktuar se shoqëria “Medi-Tel” SHPK do të depozitohet mbetjet pranë venddepozitimit të ri Qarku Elbasan si dhe kodet e mbetjeve të cilat do të depozitohen përputhen me kodet që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në kriterin kualifikues. Akoma më tej nga verifikimet rezulton se shoqëria “Eco-Elb” SHA është e pajisur me Akt Miratimi, Leje mjedisore e tipit A me nr, 6584 prot., datë 06.09.2022 me nr. identifikimi të lejes 1983/1 dhe në pikën 2.2 të saj “Përshkrimi i veprimtarisë dhe kapacitetit prodhues” përcaktohet: *“Lendfilli i mbetjeve (D1) duke përjashtuar lendfillin e mbetjeve inerte. Sipërfaqja ku zhvillohet veprimtaria është 19542 m². Ka kapacitetin i projektuar është 10 ton/ditë ose më i madh se 25 000 ton.”* pra në asnjë rast nuk e ka përcaktuar

veprimtarinë për të cilën ajo është licensuar vetëm për Qarkun Elbasan. Gjithashtu Komisioni shkon akoma më tej në arsyetimin e tij në përpjekjen për të vendosur një balancë mes kushteve faktike dhe juridike të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe përputhjes së tyre me parashikimet ligjore, nga ku rezulton se referuar lejes mjedisore të shoqërisë “Eco-Elb” SHA, ekstraktit të kësaj shoqërie si dhe aktit të themelimit të saj ku përcaktohet se veprimtaria e shoqërisë do të jetë me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës, kjo shoqëri nuk e ka të ndaluar të kryejë veprimtari me të tretët me qëllim fitimi për sa kohë ajo përputhet me objektin e veprimtarisë së saj si dhe kuadrin ligjor në fuqi.

Sa më sipër, me anë të dokumentacionit të dorëzuar në S.P.E. nga operatori ekonomik “Medi-Tel” SHPK vërtetohet se operatori ekonomik ankimues e përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.3 të dokumenteve të tenderit të “aftësitë teknike dhe profesionale”, kriteret e veçanta të kualifikimit. Kriteret e kualifikimit të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Pra, nga sa më sipër arsyetuar KPP gjykon, se operatori ekonomik “Medi-Tel” SHPK, e përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.3 “Aftësitë teknike dhe profesionale”, kriteret e veçanta të kualifikimit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Medi-Tel” SHPK qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Medi-Tel” SHPK për skualifikimin e tij me arsyen se: *“Nuk plotëson Kriterin 2.3.5 për disponimin e automjetit: Nga ekstrakti historik rezulton se ky operator ekonomik në dhjetor 2021 ka përfunduar transferimin e asetëve/aktiveve dhe aktivitetit ekonomik tek subjekti Medi Tel 1 SHPK dhe këtë e ka deklaruar dhe regjistruar si në organet tatimore edhe në QKB:”* si dhe *“3. Nuk plotëson Kriterin 2.3.5 për disponimin e automjetit: Nga ekstrakti historik rezulton se ky operator ekonomik në dhjetor 2021 ka përfunduar transferimin e asetëve/aktiveve dhe aktivitetit ekonomik tek subjekti Medi Tel 1 SHPK dhe këtë e ka deklaruar dhe regjistruar si në organet tatimore edhe në QKB. Në momentin e paraqitjes së ofertës në 14 prill 2022, ky OE nuk provon se e disponon automjetin e kërkuar, pasi të gjitha asetet si dhe veprimtarinë ekonomike, i ka transferuar që në dhjetor 2021 tek një subjekt tjetër.*

4. Nuk plotëson kriterin 2.3.6 për disponimin e impianteve dhe makinerisë: Nga ekstrakti historik rezulton se ky OE në dhjetor 2021 ka përfunduar transferimin e asetëve/aktiveve dhe aktivitetit ekonomik tek subjekti MEDI TEL 1 ShPK dhe këtë e ka deklaruar si në organet tatimore dhe në QKB.” KPP vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 8 të modifikuar të dokumenteve të tenderit, “Aftësitë teknike dhe profesionale” pika 2.3.5 dhe 2.3.6 autoriteti kontraktor ka parashikuar:

*2.3.5. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë pronësi ose me kontrate qeraje te pakten **1(nje)** automjete te izoluar hermetikisht, te identifikueshem lehtësisht gjate transportit me sinjalistiken nderkombetare te rrezikut te mbetjeve mjekesore.*

Per te vertetuar kete OE ofertues duhet te paraqese si me poshte:

Për automjet në pronësi:

- Aktin e pronësisë së mjetit
- Leje qarkullimi
- Akt - kolaudimi
- Polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet
- Akt -Miratimet Higjenosanitare te automjetit,
- Foto te makines (brenda dhe jashte) Ne fotot e sjella duhet te jene **qartesisht te dukshme targa, sinjalistika e detyrueshme dhe veshja e brendshme e automjetit sipas percaktimeve te bera ne Udhëzuesin Kombëtar “Administrimi i Sigurt i Mbetjeve Spitalore).**
- Automjetet e perdorura duhet qe te plotesojne karakteristikave te mjetit te bazuara ne piken 8.8/c dhe shtojces 4, te VKM nr.798, date 29.09.2010 Per miratimin e rregullores, ” Per administrimin e mbetjeve spitalore”si edhe pike 9.3.3 te Udhëzuesit Kombetar ” Administrimi i sigurt i mbetjeve Spitalore”.

Për automjetet që nuk janë në pronësi:

- Kontratë qiraje të shoqëruar me aktin e pronësisë së qiradhënësit, ku afati i marrjes me qira të automjetit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit objekt prokurimi,
- Leje qarkullimi,
- Akt-kolaudim
- Polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet së bashku me Akt – Miratimet Higjenosanitare.
- Foto te makines (brenda dhe jashte) Ne fotot e sjella duhet te jene **qartesisht te dukshme targa, sinjalistika e detyrueshme dhe veshja e brendshme e automjetit sipas percaktimeve te bera ne Udhëzuesin Kombëtar “Administrimi i Sigurt i Mbetjeve Spitalore).**
- Automjetet e perdorura duhet qe te plotesojne karakteristikave te mjetit te bazuara ne piken 8.8/c dhe shtojces 4, te VKM nr.798, date 29.09.2010 Per miratimin e rregullores, ” Per administrimin e mbetjeve spitalore”si edhe pike 9.3.3 te Udhëzuesit Kombetar ” Administrimi i sigurt i mbetjeve Spitalore”.

2.3.6 Operatori duhet te kete ne pronesi ose me qera impiantet per trajtimin me sterilizim dhe asgjesimin me incenerim të seciles kategori te prokuruar nga A.K te mbetjeve spitalore

sipas Ligjit Nr. 10463, date 22.09.2011, "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve", i ndryshuar, si dhe te VKM-se Nr. 798, date 29.09.2010, per miratimin e rregullores "Per administrimin e mbetjeve spitalore", (Rregullorja).

Per te vertetuar permbushjen e ketij kriteri OE, duhet te paraqese:

-Dokumentacionin per vertetimin e pronesise ose te marrjes me qera te impiantit(ku afati i marrjes me qera te jete minimalisht me afatin e ekzekutimit te ketij objekti prokurimi);

-Impiantet per trajtimin me sterilizim dhe asgjesimin me incenerim, duhet te jene te pajisur me Leje Mjedisore III.1.C dhe/ose III.1.B ose te jene pasqyruar ne Lejet Mjedisore te paraqitura ne permbushje te kriterit 3.1.1 dhe 3.1.2 me sipër;

-Katalog ose skede teknike ose cdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerisë;

-Deklaratë/Certifikate Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerisë.

III.2.2. Në përmbushje të kriterëve më sipër operatori ekonomik ka dërzuar në sistemin e prokurimit elektronik:

-Leje qarkullimi të automjetit me targë x

- Çertifikatë e kontrollit teknik të mjetit me targë x

- Policë e sigurimit të detyrueshëm të mjetit me targë x

- Certifikatë e pronësisë së mjetit me targë x

- Akt miratim leje higjieno-sanitare nr.x për automjetin me targë x

- Foto të automjetit me targë x

....

- Deklaratë doganore nr. x , datë x për autoklavë për trajtimin e mbetjeve mjeksore komplet me aksesore

- Aurorizim prodhuesi

- Certificate e Sigurimit të cilësisë nr.x

- Specifikimet teknike

- Leje mjedisore III.1.B (tipi B)

- Licence III.2.B (Incenerim)

- Akt miratimi i licenses III.2.B (Incenerim)

- Akt miratim i lejes mjedisore III.1.C (Tipi A)

- Akt miratim i lejes mjedisore III.1.B (Tipi B)

- Leje mjedisore III.1.C (Tipi A)

- Licence III.2.B autoklavim

- Akt miratim i licences III.2.B (autoklavim)

III.2.3. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", parashikohet shprehimisht se: "1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji..”

Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika 2, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.2.4. Nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Medi-Tel” SHPK me argumentin se operatori ekonomik nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.5 dhe 2.3.6 të “Aftësitë teknike dhe profesionale” kapaciteti teknik, lidhur me disponimin e automjetit dhe makinerive e pajisjeve pasi nga ekstrakti historik rezulton se ky operatori ekonomik në dhjetor 2021 ka përfunduar transferimin e asetëve/aktiveve dhe aktivitetit ekonomik tek subjekti “Medi Tel 1” SHPK dhe këtë e ka deklaruar dhe regjistruar si në organet tatimore edhe në QKB. Në momentin e paraqitjes së ofertës në 14 prill 2022, ky OE nuk provon se e disponon automjetin e kërkuar si dhe makineritë dhe pajisjet, pasi të gjitha asetet si dhe veprimtarinë ekonomike, i ka transferuar që në dhjetor 2021 tek një subjekt tjetër., KPP me shkresën nr. 1076/10 prot., datë 23.06.2022 dhe me numër 1076/13 prot., datë 06.07.2022 i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me kërkesën për informacion nëse është bërë kalimi i asetëve nga shoqëria “Medi Tel” SHPK tek shoqëria “Medi Tel 1” SHPK, si pasojë e transferimit të veprimtarisë, dhe nëse po, datën e saktë të realizimit të transferimit (kalimit të asetëve nga njëra shoqëri tek tjetra), në zbatim të ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar si dhe duke kërkuar informacion mbi asetet konkrete që janë transferuar nga shoqëria “Medi-Tel” SHPK tek subjekti “Medi-Tel 1” SHPK. Në përgjigje të kërkesës së KPP-së Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë përmes shkresës nr.18261/1 prot., datë 18.07.2022 protokolluar me tonën nr. 1076/15 prot., datë 22.07.2022 ka depozituar në KPP informacionin e kërkuar bashkëlidhur së cilës gjenden pasqyrat financiar për vitin 2021 për subjektin “Medi- Tel” SHPK dhe subjektin “Medi-Tel 1” SHPK për periudhën 31 tetor-31 dhjetor të vitit 2021 si dhe faturat tatimore të shitjes: nr. 372673802 datë 24.12.2022, nr.372673803 datë 24.12.2022, nr. 372673804, me shitës “Medi-Tel” SHPK dhe blerës “Medi-Tel 1” SHPK nga ku rezulton se në asnjërën prej tyre shoqëria “Medi-Tel” SHPK nuk i ka kaluar shoqërisë “Medi-Tel 1” SHPK automjetin apo impjantet për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve. Akoma më tej Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor në rastin konkret nëse gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës do të kishte dyshime mbi disponimin apo jo të automjetit apo impjanteve për trajtimin e dhe asgjësimin e mbetjeve në përputhje me

parashikimet ligjore e konkretisht me nenin 114 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” mund të kryente verifikime pranë palëve të treta me qëllim sigurimin e një vendimmarrje të drejtë dhe objektive, dhe nga ku Komisioni konstaton se referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ këto veprime autoriteti kontraktor nuk i ka kryer në asnjë moment. Nga sa më sipër arsyetuar Komisioni gjykon se duke u bazuar në informacionin e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë të depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik me shkresën nr, 18261/1 prot., datë 18.07.2022 protokolluar me tonën me tonën nr. 1076/15 prot., datë 22.07.2022 nga ku rezulton se përmes faturave tatimore të shitjes të datës 24.12.2021 në asnjë moment subjekti “Medi-Tel” SHPK si palë shitëse nuk i ka kaluar subjektit “Medi-Tel 1” SHPK si palë blerëse automjet apo impjante për trajtim dhe asgjësimin e mbetjeve, subjekti “Medi-Tel” SHPK i plotëson kriteret e përcaktuara në pikën 2.3.5 dhe 2.3.6 të “Aftësitë teknike dhe profesionale” kriteret e veçanta të kualifikimit.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Medi-Tel” SHPK qëndrojnë.

III.3. Lidhur pretendimet e operatorit ekonomik ankimues mbi skualifikimin e tij me arsyen se: *“OE MEDI TEL ShPK ka bërë deklaramë të pasakta dhe të pavërteta në Shtojcën nr. 9, në lidhje me disponimin e automjetit dhe impianteve e makinerive, pasi nuk i disponon ato, por disponohen nga shoqëria MEDI TEL 1 ShPK (sipas ekstraktit historik në vendimin e asamblesë së përgjithshme me datë 09.12.2021 është miratuar procesi i transferimit të veprimtarisë ekonomike nga OE MEDI TEL te marrësi MEDI TEL 1) ”* KPP gjykon se për sa kohë që sipas arsyetimit të KPP në pikën III.2.4. vërtetohet se subjekti “Medi-Tel” SHPK nuk i ka kaluar subjektit “Medi-Tel 1” SHPK automjetin dhe impjantet e trajtimit dhe asgjësimin të mbetjeve, deklaramet e bëra nga subjekti “Medi-Tel” SHPK në lidhje me makineritë dhe mjetet që disponon në shtojcën 9 *“Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”* pjesa III, seksioni B: *“Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)”* qëndrojnë dhe autoriteti kontraktor përmbajtjen e deklaruar nga operatorët në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit në kuptim të nenit 26 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së dhe rregullave të prokurimit publik.

Sa më lart pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik

gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Medi-Tel” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me Nr. REF-44722-10-06-2022, me objekt “Trajtim dhe Evadim te Mbetjeve te Rrezikshme Spitalore DSHS-KURBIN per vitin 2022- Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik – ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara- me afat 1 vjeçar (12 muaj)” me fond limit 1,000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 17.10.2022, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kurbin.
2. Autoriteti të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Medi-Tel” SHPK duke e kualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni KPP mbi zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Medi-Tel” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

